

ALARM TATIMOR
SHTATOR 2020

Për t'ju informuar me ndryshimet më të fundit në legjislacionin ligjor dhe financiar, ky alarm tatimor i përgatitur nga "A.R.S Legal & Financial Services" Ltd, ju ofron informata të vlefshme mbi publikimet më të fundit të legjislacionit shqiptar.

Në Fletoren Zyrtare Nr. 161, datë 09/09/2020 është botuar VKM Nr. 690, datë 2.9.2020 "Për përcaktimin e procedurave të zhvillimit të garës, kriteret shtesë për aplikantët që konkurrojnë për t'u pajisur me licencë për kategorinë "Kazino", e procedura e shpalljes së fituesit, si dhe rastet e revokimit apo të pezullimit të kësaj licence."

Ky vendim përcakton procedurat e zhvillimit të garës, kriteret shtesë për aplikantët që konkurrojnë për t'u pajisur me licencë për kategorinë "Kazino" e procedurën e shpalljes së fituesit, si dhe rastet e revokimit apo të pezullimit të kësaj licence.

Organi kompetent për hapjen e garës për dhënien e licencës dhe lëshimin e saj për kategorinë "Kazino" është Autoriteti i Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit (*këtu e më poshtë AMLF*).

AMLF publikon njoftimin për hapjen e garës dhe administron dokumentacionin e depozituar nga palët e interesuara. Kushtet bazë të nevojshme për të aplikuar për dhënien e licencës për kategorinë "Kazino" janë si më poshtë vijon:

- a) të jetë shoqëri aksionare, me seli në Republikën e Shqipërisë;

TAX ALERT
SEPTEMBER 2020

To keep you up to date with the latest changes in Albanian legislation, this tax alert prepared by "ARS Legal & Financial Services" Ltd provides you with valuable information on the latest publications of the Albanian legislation.

In the Official Gazette No. 161, dated 09.09.2020 is published DCM No. 690, dated 2.9.2020 "On determination of procedures of the competition, additional criteria for applicants competing to obtain a license for the category "Casino", the procedure of announcing the winner, as well as the occasions of revocation or suspension of this license."

This decision determines the procedure of conducting the competition, additional criteria for applicants competing to obtain a license for the category "Casino", the procedure of announcing the winner, as well as the occasions of revocation or suspension of this license.

The competent Authority to opening the competition to giving and issuing the license for the category "Casino" is the Authority of Supervising Games of Luck (*hereinafter ASGL*).

The ASGL publishes the notice for opening of the competition and administers documents as submitted by the interested parties. The fundamental condition necessary to applying to obtain the license for the category "Casino" are as follows:

- a) established as a joint stock company, headquartered in the Republic of Albania;

<p>b) të ketë në objektin e veprimtarisë së saj lojërat e fatit, sipas llojit të lojës që kërkohet si dhe të ketë eksperiencë në fushën e lojërave të fatit;</p> <p>c) shuma e kapitalit duhet të jetë jo më pak se 1 200 000 000 (një miliard e dyqind milionë) lekë;</p> <p>d) të deklarojë burimin e kapitalit që do të investohet për ushtrimin e veprimtarisë në fushën e “Kazinosë”;</p> <p>e) të ketë kapacitetet e duhura financiare, administruese, organizative dhe besueshmërinë për t’u angazhuar me sukses në projekte të tilla;</p> <p>f) të paraqesë garancinë pasurore, së bashku me aplikimin dhe me kushtet e sekuestrimit tëkësaj garancie;</p> <p>g) të paraqesë kufizimet për ndryshimet e pronësisë së aksioneve për të licencuarit;</p> <p>h) të ngrejë serverin, në të cilin do të japë informacion të plotë mbi çdo transaksion që do të kryhet midis subjektit dhe lojtarëve, xhiron dhe fitimin, si dhe çdo të dhënë që do të kërkohet nga AMLF-ja në lidhje me zhvillimin e këtij aktiviteti. AMLF-ja do të ketë akses në kohë reale te ky server.</p> <p>Për të vërtetuar përmbushjen e kërkesave të përcaktuara më sipër, aplikanti duhet të paraqesë dokumente mbështetëse, sipas kërkesave ligjore të parashikuara në këtë vendim.</p> <p>Përpos dokumentacionit shoqërues, subjekti i interesuar dorëzon edhe:</p> <p>i) dëshmi penaliteti (për aplikuesin/administratorin/aksionarin e shoqërisë); vërtetim se nuk janë në proces gjyqësor apo se nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë për vepra penale fushën e krimit ekonomik, evazionit fiskal dhe/apo doganor, shpërdorim detyre, mitmarrje apo mitdhënie, vjedhje, trafik lëndësh narkotike apo armësh, eksplozivësh, mospagim gjobash apo për vepra të tjera</p>	<p>b) Having on its object of activity the games of luck, according to the type of the required game as well as having experience in the field of games of luck;</p> <p>c) The sum of capital must be no less than ALL 1 200 000 000 (one milliard and two hundred million);</p> <p>d) The interested subject should declare the source of capital to be invested for exercising the activity in the field of “Casino”;</p> <p>e) Should have the proper financial, management, organizational capacities and credibility to be successfully engaged in such projects;</p> <p>f) Presents guarantee of assets, along with the application and conditions of sequestration of this guarantee;</p> <p>g) Presents restrictions to changing the proprietorship of shares for the licensed;</p> <p>h) Establishes the server by which will deliver full information over each transaction that will be completed between the subject and the players, turnover and profits, as well as any other data as required upon ASGL’s request in relation with the conduction of this activity. ASGL will have access over this server on real time.</p> <p>The applicant should submit supporting documents, according to legal requirements as set out in this Decision, in order to prove the fulfillment of the above - mentioned requirements.</p> <p>Among the accompanying documents, the interested subject submits</p> <p>i. Certificate of non-criminal records (of the applicant/administrator/shareholder of the company); a attestation for not being part of a court proceeding or that not having been convinced by a final decision for criminal offences in the field of economic crime, tax evasion and/or customs, abuse of power/authority, bribery, theft, trafficking of narcotics or weapons, explosives, non-payment of fines or other criminal deeds,</p>
---	--

<p>penale, që kompromentojnë personat në nderin e personalitetin e tyre;</p> <p>ii) një marrëveshje paraprake me një bankë të nivelit të dytë, me seli në R.SH tek e cila do të kryhen transfertat, arkëtimet, depozitimet;</p> <p>iii) deklaratat të ndryshme sipas kërkesave ligjore të parashikuara në këtë vendim;</p> <p>iv) cdo informacion tjetër që cmohet i nevojshëm për t'u administruar nga Autoriteti i autorizuar.</p> <p>Për sa më sipër, aplikuesi dorëzon një autorizim sipas të cilit lejon Autoritetin të kryejë verifikimet përkatëse të dokumentacionit/informacionit të depozituar. <i>Në mungesë të këtij autorizimi, aplikimi refuzohet.</i></p> <p>Krahas dokumentacionit bazë dhe dokumentacioneve shoqëruese, subjekti aplikues duhet të paraqesë dokumente për kapacitetet organizative dhe administrative, sikurse janë deklaratat për fuqinë punëtore, pajisjet teknike që do të përdoren në funksion të ushtrimit të veprimtarisë dhe që përmbushin standardet kombëtare apo ato të kërkuara nga Ligji Nr. 155/2015 “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.</p> <p>Autoriteti merr dosjen në shqyrtim brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e depozitimit të dokumentacionit dhe njofton brenda këtij afati për pranimin ose refuzimin e aplikimit.</p> <p>Në rast të pranimit të aplikimit, AMLF-ja informon subjektin për miratimin e kërkesës për licencim dhe i kërkon të paguajë tarifën e licencimit sipas kategorisë (përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë të Financave “Për mënyrën dhe afatet për kryerjen e pagesës së tarifës së licencimit për secilën kategori të lojërave të fatit” si dhe të bëjë ngurtësimin e fondit të garancisë për fituesin e lojërave të fatit e të fondit të garancisë për shlyerjen e detyrimeve periodike ndaj institucioneve shtetërore.</p> <p><i>Mosplotësimi i këtyre dy kërkesave passjell pezullim dhe/ose heqje të licencës.</i></p>	<p>compromising persons in their honor and personality</p> <p>ii. a prior agreement with a bank of second level, headquartered in the Republic of Albania where the transactions, collections and deposits shall be completed;</p> <p>iii. different declarations according to legal requirements as set out in this decision</p> <p>iv. any other information apprised necessary to be administered by the authorized authority.</p> <p>As of above, the applicant shall submit an authorization giving permission to the Authority to conduct relevant verifications of the submitted documents/information. <i>In the absence of this authorization, the application shall be refused.</i></p> <p>Among the fundamental documentation and accompanying documents, the applicant should present documents related to management and administrative capacities such as declarations of labor force, technical devices to be used in order to exercise the activity and that fulfill the national standards or standards required by Law No. 155/2015 “On games of luck in the Republic of Albania”, as amended.</p> <p>The authority shall scrutinize the file within 30 (thirty) days from the date of submission of the documents and shall notify within the above mentioned term on the acceptance or refusal of the application.</p> <p>In case of acceptance of the application, ASGL shall inform the subject on the approval of the request to licensing and seeks for payment of licensing fee according to the category (as determined in the Instruction of the Minister of Finance “On the manner and terms of conducting the payment of licensing fee for each category of lucky games” as well as freezing guarantee fund for the winner of the lucky games and of the guarantee fund for expiation or periodic liabilities toward state institutions.</p> <p><i>Failure to meet the two above mentioned requirements evokes suspension and/or removal of the license.</i></p>
--	---

Me VKM Nr. 689, datë 2.9.2020, publikuar ne Fletoren Zyrtare Nr. 161, datë 08/09/2020 është përcaktuar zona (në qytetin e Tiranës) ku mund të vendosen lojërat e fatit, kategoria “KAZINO”. Subjektet e interesuara të licencuara lejohet të zhvillojnë këtë veprimtari brenda kufizimeve të rrugëve, si më poshtë vijon:

“Rruga: “Barrikadave”; Rruga: “Urani Pano”; Rruga: “Dedë Gjon Luli”; Rruga: “Ibrahim Rrugova”; Bulevardi: “Zhan D’Ark”, Rruga: “Xhorxh W. Bush”.

Në Fletoren Zyrtare Nr.171, datë 24/09/2020 është botuar Udhëzimi Nr. 36, datë 21.9.2020 “Për një ndryshim në Udhëzimin Nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili parashikon një ndryshim në pikën 5.7 të Udhëzimit dhe konkretisht “*Çdo zvogëlim kapitali, që nuk ka për qëllim zvogëlimin e humbjeve dhe që destinohet për shpërndarje ortakëve, do të konsiderohet dividend dhe do të tatohet si i tillë ..* “duke zëvendësuar parashikimin e mëparshëm ku citohet “*Çdo zvogëlim kapitali, që nuk ka për qëllim zvogëlimin e humbjeve, do të konsiderohet dividend i tatueshëm dhe do të tatohet me 15% ...*”.

Nëse dëshironi të dini më shumë për ndryshimet në legjislacionin shqiptar, na kontaktoni si më poshtë:

Email: info@arsfirm.al

Telefon: +355 69 247 6387

Web: www.arsfirm.al

Adresa e zyrës

Rruga "Kavaja" Qendra " Sun Tower ", Kati 6^{të}, Ap. nr. 31, Tiranë, Shqipëri

©A.R.S Legal & Financial Service

DCM No. 689, dated 2.9.2020, published in the Official Gazette No. 161, dated 08/09/2020 determines the areas (in Tirana) in where games of luck, category “Casino” can be placed. According to this Decision, the licensed interested subjects are allowed to exercise this activity within the restrictions of the streets, as below determined:

“Str. “Barrikadave”; Str. “Urani Pano”; Str. *Dedë Gjon Luli*”; Str. “Ibrahim Rrugova”; Boulevard “Zhan D’Ark”, Str. “Xhorxh W. Bush”.

In the Official Gazette No. 171, dated 24/09/2020 is published Instruction No. 36 dated 21.9.2020 “On an amendment to Instruction No. 5, dated 30.01.2006 “On income tax”, as amended, which stipulates for an amendment to point 5.7 of the Instruction and more precisely “*Each reduction of capital, that is not intended to reduce the losses and is intended for distribution to shareholders, shall be deemed dividend and shall be taxed as such ...* “ by substituting the previous definition, quoted “*Each reduction of capital, that is not intended to reduce the losses, shall be deemed taxable dividend and shall be taxed by 15% ...*”.

If you wish to know more on the Albanian legislation, contact us as follows:

Email: info@arsfirm.al

Phone: +355 69 247 6387

Web: www.arsfirm.al

Office Address

“Kavaja” Street, “Sun Tower” Center 6th Floor, Apt no. 31, Tirana, Albania

©A.R.S Legal & Financial Service